



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

**Prokuroria Tiranë kërkon konfiskimin e mbi 2.5 milionë euro pasuri të shtetasit
N.Gj, dhe familjarëve të tij: Rrjedhin nga veprimtaria kriminale**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë paraqiti kërkesën për konfiskimin e të paktën 2.5 milionë euro pasuri të shtetasit N.Gj. i cili ka ndërruar jetë në vitin 2020 si pasojë e një atentati me armë zjarri dhe e familjarëve të tij, pasi u provua se lidhen dhe rrjedhin nga veprimtaria kriminale.

Në kuadër të hetimeve mbi procedimin pasuror nr.03, të vitit 2023, në ngarkim të këtij shtetasi, rezultoi se i ndjeri ka qenë pjesë e një grupi kriminal i cili fushë kryesore të aktivitetit të tij kriminal kishte veprën penale ‘Trafikimit të lëndëve narkotike’ parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Prokuroria provoi se shtetasi N.Gj., ka qenë nën hetim në Hollandë për veprën penale të ‘Pastrimit të parave’ ndërsa më parë ka qenë i arrestuar dhe i dënuar për drogë në Itali. Nga analiza e fakteve dhe e dokumentacionit të administruar, përse i përket pasurive të shtetasit N.Gj. dhe familjarëve të tij, rezultoi se kanë një nivel të pajustificuar ekonomik dhe dyshohet se 13 pasuritë e paluajtshme i kanë fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale.

Bazuar sa më sipër, prokuroria vlerësoi se pasuritë e tij dhe familjarëve plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi N. Gj, ka qenë i përfshirë në veprimtarinë kriminale të veprës penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh” dhe “Pastrimi i parave” .

Për këtë arsye, prokuroria kërkon konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurive të mëposhtme:

1. Apartament me sipërfaqe 87.30 m²;
2. Apartament me sipërfaqe 87.30 m²;
3. Apartament me sipërfaqe 87.30 m²;
4. Garazh me sipërfaqe 15.00 m²;
5. Garazh me sipërfaqe. 15.00 m²;
6. Garazh me sipërfaqe. 15.00 m²;
7. Garazh me sipërfaqe 15.00 m²;
8. Apartament me sipërfaqe 617.84 m²;
9. Apartament me sipërfaqe 87.30 m²;
10. Njësi me sipërfaqe 45.21 m²;

11. Garazh me sipërfaqe 15 m²;
12. Garazh me sipërfaqe 15 m²; dhe
13. Apartament me sipërfaqe 99.70 m².